



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, seksioni dygjuhësh
(kurrikula e vjetër)

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Gjergj Elez Alia**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 **1 pikë****Arsyeja**

- Është një luftë psikologjike. Për ta mbajtur nën tension kundërshtarit.
- Karakteristikë e eposeve; në fillim vjen ndeshja me fjalë më pas ndeshja me armë.

1 pikë Nëse tregon arsyen e ndeshjes me fjalë përpara dyluftimit.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 **2 pikë**

- **Motërzeza:** fjalë e përbërë
- **Formimi:** motër+zeza

1 pikë Nëse tregon llojin e fjalës për nga mënyra e ndërtimit.

DHE

1 pikë Nëse tregon mënyrën e ndërtimit të saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Qyqja është simbol i trishtimit, i dhimbjes, i vetmisë. Thekson notat elegjiake të këngës.
- Ndjesia që përcillet është ajo e dhimbjes, e vajit, e trishtimit, por edhe vlerësimit për trimin e rënë.

1 pikë Nëse tregon se ç'përfaqëson qyqja.

DHE

1 pikë Nëse tregon ndjesitë që përcjell ajo te lexuesi apo dëgjuesi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 (a) 1 pikë**Model përgjigjeje**

➤ **Kontrasti:** mali ka dushkue, ka ardhur pranvera dhe çdo gjë ka lulëzuar, por lisi është tharë, saraji është i zi.

Ose

➤ Në një anë kemi pranverë, me ngjyrat e saj (që nënkuptohet në malin e gjelbëruar) dhe në anën tjetër kemi sarajin e zi, lisin e tharë.

1 pikë Nëse gjen kontrastin në fund të këngës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 (b) 4 pikë**Detajet:**

- mali me u dushkue,
- blini të tanë *degash tha*
- saraj të zi
- shembë përdhe

Efekti i shprehësisë:

➤ Theksohet zgjatja e dhimbjes pas vdekjes së Gjergjit, në shtëpi të tij nuk lulëzon më asgjë, pasi trimi ka vdekur. Çdo gjë është shkretë, pushtuar nga zia dhe ngjyrat e errëta. Theksohet zymtësia, në një kohë që rreth e qark natyra lulëzon dhe jeta vazhdon, por jo ajo e Gjergjit.

OSE

➤ Theksohen ngjyrat e përzishme dhe përmasat e humbjes tragjike.

3 pikë Nëse identifikon tri nga detajet e mësipërme.

DHE

1 pikë Nëse tregon efektin e shprehësisë që krijojnë ato.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 2 pikë**Momentet zakonore:**

- Vajtimi i të vdekurit me zë;
- Ndërtimi i një murane;
- Mbjellja e një bliri te varri.

2 pikë Nëse identifikon dy momente zakonore

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një moment zakonor.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **2 pikë****Efekti:**

➤ vuajtje, dhimbje, hidhërim

Përsëritja e tingujve : ah, oh, kah, krr, i, japin efektin dëgjimor të zërit të qyqes. Janë nota elegjiake, të klithmës.

Mjeti stilistik:

➤ aliteracioni.

1 pikë Nëse tregon efektin tingullor që përftohet në vargjet e fundit të këngës.

DHE

1 pikë Nëse gjen mjetin stilistikor që e krijon atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **2 pikë****Kultet:**

- Kulti i nderimit të të vdekurve: *E i muranë t'bukur e kanë mbarue*
- Kulti i nderimit të të parëve: *se ne t'parët' një kanun na kanë lanë*
- Kulti i nderit: *kurrë Balozit motrën mos me ia dhanë*

2 pikë Nëse gjen dy kulte bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një kult bashkë me ilustrimin përkatës.

OSE

1 pikë Nëse gjen dy kulte ose një kult, por pa ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II**Viktor Hygo*****Katedralja e Parisit***

Pyetja 15 **B** **1 pikë**

Pyetja 16 **A** **1 pikë**

Pyetja 17 **B** **1 pikë**

Pyetja 18 **B** **1 pikë**

Pyetja 19 **D** **1 pikë**

Pyetja 20 **B** **1 pikë**

Pyetja 21 **3 pikë****Model përgjigjeje****Përgjigje e plotë**

- Esmeralda është e dërrmuar, e mjerë. Është e veshur keq, e dobësuar nga trajtimi që i është bërë, e përbuzur dhe e neveritur. Ajo ka turp dhe ndihet shumë keq.

Përgjigje e pjeshme

- Është e lodhur
- Është e mjerë
- Është dërrmuar, etj

Arsyeja

- Po e çojnë për ta ekzekutuar. Esmeralda ka turp pasi po e shohin shumë njerëz, është e veshur keq dhe e tallur nga të gjithë.
- Duket që duhet të ketë vuajtur shumë (është e dobësuar dhe e ngrirë, pa asnjë emocion).

2 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të plotë gjendjen në të cilën ndodhet Esmeralda.

OSE

1 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të pjeshme gjendjen në të cilën ndodhet Esmeralda.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e kësaj gjendjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (a) **2 pikë**

- Po. Kanë qenë të lidhur. Kjo kuptohet nga sjellja e kapitenit.

Momentet:

- mos u turbulluat që e patë atë grua.
- Febysit, që ia kishte ngulur sytë qerres dhe ishte zbehur shumë.
- Ajo që e qetësonte pak ishte se e dënuara e mjerë nuk i ngrinte sytë nga fundi i qerres.

2 pikë Nëse zbulon dy momente që tregojnë se Febysi dhe Esmeralda kanë qenë të lidhur.

OSE

1 pikë Nëse zbulon një moment që tregon se Febysi dhe Esmeralda kanë qenë të lidhur.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (b) **2 pikë**

- E vetmja ndjenjë që e pushton është ajo e turpfit.
- E pushton kjo ndjenjë, pasi është e vetme përpara një turme që po e shikon. Është e lekosur, e katandisur si mos me keq dhe kjo e trondit shumë.

1 pikë Nëse tregon ndjenjën më të fortë që e pushton Esmeraldën.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen se pse pikërisht kjo ndjenjë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 (a) 2 pikë**Kontrastet**

- Esmeralda e bukur, e hijshme, e brishtë, me supe të njoma – litari i trashë, rreth qafës së saj.
- Supet e njoma – litari i ashpër, i përhimët
- Lulja- krimbi
- Esmeralda – turma

Shpjegimi

Kontrasti thekson brishtësinë e vajzës, përpara vrazhdësisë që e rrethon. Ai e bën më emocionuese dhe prekëse figurën e saj.

1 pikë Nëse identifikon një rast të përdorimit të kontrastit.

DHE

1 pikë Efektin që krijon kjo kundërvënie.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 1 pikë**Detajet**

- mënyra e ekzekutimit;
- trikëmbëshi;
- flokët që priteshin;
- qerrja ku ndodhet vajza (përdorej në mesjetë), ose qerrja;
- kalorësit me livre ose kalorësit;
- ekzekutimi në shesh.

1 pikë Nëse identifikon një detaj që e vendos këtë ngjarje në mesjetë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Përshkrimi fizik: ka detaje shumë interesante: flokët, qafa e hollë, litari rreth qafës, sytë e çakërritur, trupi që i lëkundet në karrocë, këmbët e zathura, trupi si një send, i ngrirë, i vdekur, sytë pa lot, e brishtë, e ligsh, e hequr. Por e bukur: flokët shumë të zinj, profili i zbehtë, i kulluar. Të gjitha krijojnë një imazh shumë prekës, lëvizës, të gjallë. Të duket sikur e shikon.

OSE

- Përshkrimi i gjendjes shpirtërore: ndjenja e turpit, e dërrmuar, e dëshpëruar, e mpirë nga shtangimi. Të gjitha detajet përçojnë te lexuesi një ndjenjë keqardhjeje. Efektet janë shumë të dukshme. Hygo është mjeshtër i përdorimit të detajeve shumë emocionuese që krijojnë efekte të forta te lexuesi.

2 pikë Nëse identifikon një grup detajesh që mbrojnë pozicionin e marrë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon qartë funksionin që ato luajnë në mbështetje të mendimit që ka.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se cilin preferon më shumë: të lexojë librin apo të shikojë filmin;
- përdor argumente që mbështesin zgjedhjen e bërë.
- përdor ilustrime nga vepra ose filmi për të mbështetur shpjegimet e dhëna;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.